

Raporti i vitit 2019 për Liritë Fetare Ndërkombëtare: Kosova

Përmbledhje ekzekutive

Kushtetuta ndalon diskriminimin fetar dhe parashikon liri fetare që u nënshtrohen kufizimeve për të siguruar rend publik, shëndet dhe siguri ose për t'i mbrojtur të drejtat e të tjerëve. Ligji nuk parashikon ndonjë mënyrë që grupet fetare të fitojnë status juridik. Kuvendi i Kosovës (Parlamenti) nuk i mori parasysh projektligjet që do t'u lejonin grupeve fetare ta fitojnë status juridik dhe të bëjnë biznes në emrin e tyre. Ndonëse grupet fetare thanë që në përgjithësi kishin marrëdhënie bashkëpunimi me qeverinë lokale, Kisha Protestante Ungjillore e Kosovës (KPUK) tha që qeveritë komunale nuk i trajtonin njëloj organizatat fetare në çështje të pronës, përfshirë dhënien e lejeve për ndërtim dhe ndarjen e hapësirës për varrosje në varrezat publike. KPUK dhe të tjerë gjithashtu thanë që Bashkësia Islame e Kosovës (BIK) mbajti kontrata për t'i udhëhequr shumë varreza komunale dhe i diskriminoi grupet fetare të pakicave në ndarjen e parcelave për varrim dhe në ofrimin e shërbimeve. Përfaqësueses të Kishës Ortodokse Serbe (KOS) thanë se qeveria i shkeli disa të drejta pronësore të Kishës, të përcaktuara me Ligjin për zonat e veçanta të mbrojtura (ZVM), si refuzimi për ta zbatuar një vendim gjyqësor të para tri vjetëve për ta njohur pronësinë e KOS-it për disa parcela toke rreth Manastirit të Deçanit dhe vazhdimin e ndërtimit të rrugëve që kërcënuan të shtriheshin në ZVM. Sipas KOS-it, asnjë zyrtar komunal nuk u mbajt përgjegjës për këtë refuzim. BIK-u raportoi për dy raste të diskriminimit në punësimin ndaj myslimanëve. Disa zyrtarë të BIK-ut theksuan që niveli i ndjenjave anti-myslimane në media ishte rritur dhe thanë se kjo mund t'i dëmtonte mundësitë e punësimit të myslimanëve të devotshëm.

Policia Kombëtare raportoi për 61 incidente me motive fetare, shumica prej tyre kishin në shënjestër vendet fetare, përfshirë varrezat, në nëntë muajt e parë të vitit. Shumë incidente ishin të lidhura me përkatësinë etnike dhe fenë. Më 6 janar, shqiptarët e Kosovës kërcënuan një prift të KOS-it para kishës së tij në Novobërdë. Më 13 korrik dhe 16 dhjetor, persona të panjohur vandalizuan varrezat ortodokse në Lipjan. Qeveria qendrore dhe qeveritë komunale menjëherë i dënuan incidentet dhe apeluan për veprim të organeve të zbatimit të ligjit për kapjen e autorëve. Në Gjakovë, më 6 janar, shqiptarët e Kosovës protestuan para kishës lokale ortodokse serbe kundër asaj që ata e quanin vizitë e "kriminelëve të maskuar si pelegrinë", duke i detyruar serbët e zhvendosur ta anulojnë pelegrinazhin e tyre vjetor të Krishtlindjes Ortodokse në kishë për shkaqe arsye.

Zyrtarë të Ambasadës së SHBA-së vazhduan ta inkurajonin qeverinë për zbatimin e mekanizmave për t'i mbrojtur vendet fetare dhe për t'i zbatuar vendimet gjyqësore që kishin të bënin me KOS-in, si dhe zgjidhjen e kontesteve pronësore të KOS-it. Ambasadori dhe përfaqësues të tjerë të Ambasadës u takuan me udhëheqës fetarë për t'i diskutuar shqetësimet e tyre dhe i inkurajuan që ta nxisnin tolerancën fetare dhe ta përmirësonin dialogun ndërfetar. Në nëntor, Ambasadori amerikan për Liri Fetare Ndërkombëtare u takua me përfaqësuesit e të gjitha bashkësive kryesore fetare dhe, në një tubim me të rinjtë nga grupet fetare dhe laike, apeloi për liri dhe pluralizëm më të madh fetar.

Seksioni I. Demografia fetare

Qeveria e SHBA-së vlerëson që numri i përgjithshëm i popullsisë është 1,9 milionë banorë (vlerësim i mesit të vitit 2019). Sipas të dhënave zyrtare të regjistrimit të vitit 2011, 95,6 për qind e popullsisë identifikohen si myslimanë, 2,2 për qind si katolikë romanë dhe 1,4 për qind si serbë ortodoksë, me protestantë, hebrenj dhe persona që nuk përgjigjeshin ose u përgjigjën

“tjetër” ose “asnjë”, që së bashku përbënin më pak se 1 për qind. Sipas KOS-it dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, bojkotimi i regjistrimit të vitit 2011 nga serbët dhe parregullsitë në regjistrimin e popullsisë rezultuan në llogaritje më të ulët të anëtarëve të KOS-it. Bashkësitë e tjera fetare, përfshirë tarikatet dhe protestantët, gjithashtu i kontestuan të dhënat e regjistrimit, duke thënë që nuk i besonin metodologjisë së regjistrimit të përgjithshëm dhe besuan që kjo rezultoi në llogaritje më të ulët të anëtarëve të komunitetit të tyre.

Sipas BIK-ut, shumica e myslimanëve i përkasin shkollës Hanafi Suni, ndonëse disa janë pjesë e komunitetit Sufi Tarikat. Ekziston edhe një komunitet i vogël fetar Sufi Bektashi; nuk ka asnjë vlerësim zyrtar për numrin e adhuruesve të tij. Shqiptarët e Kosovës, gjuha e të cilëve është shqipja, përbëjnë shumicën në 28 nga 38 komunat e vendit, dhe serbët e Kosovës, gjuha e të cilave është serbishtja, përbëjnë shumicën në 10 komunat e tjera. Pjesa më e madhe e anëtarëve të KOS-it banojnë në 10 komunat me shumicë serbe. Komunitetet më të mëdha katolike janë në Gjakovë, Janjevë, Klinë, Prishtinë dhe Prizren. Popullatat protestante ungjillore janë të vendosura në gjithë vendin, të përqendruara në Prishtinë dhe Gjakovë. Ka bashkësi të vogla hebraike në Prizren dhe Prishtinë.

Shumica e shqiptarëve të Kosovës janë myslimanë, ndonëse disa janë të krishterë (ortodoksë, katolikë dhe protestantë); pothuajse të gjithë serbët e Kosovës i përkasin KOS-it. Shumica e ashkalinjve, boshnjakëve, egjiptianëve, goranëve, romëve dhe turqve janë gjithashtu myslimanë, ndërsa shumica e malazezëve etnikë dhe disa romë janë ortodoksë të krishterë dhe pothuajse të gjithë kroatët etnikë janë katolikë.

Seksioni II. Statusi i respektimit të lirisë fetare nga Qeveria

KORNIZA LIGJORE

Kushtetuta parashikon të drejtën e lirisë së ndërgjegjes dhe fesë për të gjithë qytetarët, përfshirë të drejtën për ta ndërruar, shprehur apo për të mos e shprehur besimin fetar, për ta ushtruar fenë apo për të mos e ushtruar fenë, dhe për t’iu bashkuar apo refuzuar për t’iu bashkuar një bashkësie fetare. Këto të drejta u nënshtrohen kufizimeve për shkak të sigurisë dhe rendit publik ose për ta mbrojtur shëndetin apo të drejtat e të tjerëve. Kushtetuta parashikon ndarjen e bashkësive fetare nga institucionet publike, përfshirë të drejtën e grupeve fetare për t’i rregulluar në mënyrë të pavarur organizimet, aktivitetet dhe ceremonitë e tyre, dhe të drejtën për të themeluar shkolla fetare dhe institucione bamirësie. Ajo garanton të drejta të barabarta për të gjitha bashkësitë fetare, përcakton që vendi është shtet laik dhe neutral lidhur me fenë, deklaron që shteti do ta sigurojë mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë fetare të vendit dhe ndalon diskriminimin e bazuar në fe. Kushtetuta përcakton që ligji mund ta kufizojë lirinë e shprehjes për ta parandaluar provokimin e dhunës dhe armiqësisë për shkak të racës, nacionalitetit, përkatësisë etnike apo fesë. Ajo u lejon gjykatave t’i ndalojnë organizimet apo aktivitetet që inkurajojnë urrejtje racore, nacionale, etnike apo fetare.

Kushtetuta parashikon Institucionin e Avokatit të Popullit, i cili është përgjegjës për monitorimin e lirisë fetare, ndër të drejta të tjera të njeriut, dhe për rekomandim të veprimeve për t’i korrigjuar shkeljet. Kushtetuta përcakton që shteti do t’i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për t’i mbrojtur individët që mund të jenë subjekt i kërcënimit, armiqësisë, diskriminimit apo dhunës për shkak të identitetit të tyre fetar.

Ligji nuk kërkon regjistrimin e grupeve fetare, por as nuk parashikon ndonjë mekanizëm ligjor ose udhëzim specifik që grupet fetare të fitojnë status ligjor përmes regjistrimit apo mënyrave

të tjera. Pa status ligjor, grupet fetare nuk mund të posedojnë pronë, të hapin llogari bankare, të punësojnë personel, të kenë qasje në gjykata si entitet, ndonëse kishat individuale ose anëtarë individualë mund të kenë qasje në gjykata apo të kryejnë punë të tjera administrative në emër të tyre. Komunitetet lokale shpesh njohin posedimin e ndërtesave nga grupet fetare; megjithatë, ligji në përgjithësi nuk i mbron këto ndërtesa si pronë të një komuniteti fetar, por përkundrazi si pronë private të qytetarëve. Prona e KOS-it bën përjashtim: Ligji për ZVM-në pranon dhe mbron integritetin e pronësisë së pronave të KOS-it dhe kujdestarinë për zona të caktuara.

Ligji përcakton që nuk ka fe zyrtare, por i rendit pesë bashkësi “tradicionale” fetare që marrin mbrojtje dhe përfitime shtesë, përfshirë taksat e reduktuara. Ligji parashikon lirinë e praktikave fetare ose jofetare, të drejtën për të krijuar organizata humanitare/bamirësie, pranimin e kontributeve vullnetare financiare nga individë dhe institucione dhe mbrojtjen e komunikimit kombëtar dhe ndërkombëtar për qëllime fetare.

Ligji parashikon mbrojtje për vendet me rëndësi fetare e kulturore dhe ndalon ose kufizon aktivitetet në afërsi që mund ta dëmtojnë mjedisin e tyre historik, kulturor apo natyror. Sipas ligjit, Këshilli për Zbatim dhe Monitorim (KZM) gjykon kontestet mes Qeverisë dhe KOS-it lidhur me ZVM-të dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e trashëgimisë fetare e kulturore të KOS-it. KZM-ja është organ i posaçëm që rrjedh nga Propozimi Gjithëpërfshirës i vitit 2007 për zgjidhjen e statusit të Kosovës (i njohur si Plani i Ahtisaarit) dhe i themeluar me ligj. Anëtarë të KZM-së janë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si bashkëkryesuese (tani e konsoliduar nën kompetencën e Ministrisë së Infrastrukturës); Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS); KOS-i; Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian (si bashkëkryesues); dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).

Komunat janë ligjërisht përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe meremetimin e të gjitha varrezave publike, përfshirë varrezat e caktuara për bashkësitë specifike fetare.

Sipas ligjit, “institucionet e arsimit publik duhet të përmbahen nga mësimdhënia fetare ose aktivitetet e tjera që përhapin fe specifike”. Ky ligj nuk zbatohet në shkollat që veprojnë nën strukturat paralele të udhëhequra nga Qeveria e Serbisë, mbi të cilat Qeveria e Kosovës nuk ka kontroll.

Një qarkore administrative e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) me fuqi të ligjit për kodin e sjelljes dhe masat disiplinore për nxënësit e shkollave të mesme të larta ua ndalon nxënësve të mbajnë “uniforma” fetare në ambientet e shkollave fillore e të mesme.

Vendi nuk është palë e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike.

PRAKTIKAT QEVERTARE

Gjatë vitit, parlamenti nuk i konsideroi ndryshimet në Ligjin për Lirinë Fetare që u lejon grupeve fetare të fitojnë status juridik, të bëjnë biznes dhe të fitojnë pronë të paluajtshme e personale në emrin e tyre, të hapin llogari bankare dhe të fitojnë përfitime nga taksat e importit. Ndryshimet do ta sqaronin edhe identitetin dhe statusin e disa grupeve fetare, si komuniteti Bektashi, i cili kërkoi njohje si bashkësi e veçantë islame. Ndryshimet kaluan në lexim të parë në Kuvend në vitin 2017, dhe Kuvendi i rishikoi ato në vitin 2018, por kurrë nuk votoi për to. Për ta rifilluar shqyrtimin e legjislacionit, qeveria do të duhej ta rifillonte këtë proces duke e ridërguar atë në kuvend. Në mungesë të zbatimit të legjislacionit, të gjitha bashkësitë fetare thanë që vazhduan të operonin llogari bankare të regjistruara në emër të individëve në vend të

komuniteteve. Përveç kësaj, komunitetet, si KPUK-u, thanë që vazhduan të tatoheshin si biznese fitimprurëse.

Sipas BIK-ut, nuk ka pasur raste që nxënësve apo mësimdhënësve myslimanë u është mohuar qasja në shkolla si rezultat i dekretit të qeverisë që ndalonte veshjen fetare në pronat e shkollës. Ndërsa qarkorja administrative e MASHT-it u referohet vetëm nxënësve të shkollave të mesme, udhëheqësit e komunitetit mysliman raportuan për diskriminim në punësimin e aplikantëve myslimanë në Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), përfshirë një rast kundër një gruaje myslimane, dhe diskriminimin e mësimdhënësve/ligjëruesve dhe aplikantëve të menaxhmentit të shkollave për ata që vishnin veshje fetare.

Në korrik, zyrtarë të MASHT-it u takuan me një përfaqësues të BIK-ut për të diskutuar për ndalimin e veshjes fetare, por ndalesa mbeti në fuqi në fund të vitit. Kandidatë nga parti të shumta që garonin për poste në zgjedhjet parlamentare të tetorit gjithashtu kritikuan ndalesën. BIK-u ofroi një shembull të FSK-së që ia mohonte një pjesëtareje lejen për ta veshur hixhabin me uniformë.

Shumica e komunave kanë pasur marrëveshje vjetore me BIK-un për t'i rregulluar ceremonitë e varrimit të qytetarëve. Disa bashkësi fetare ose etnike, përfshirë komunitetin protestant dhe myslimanët nga komuniteti rom, thanë që kjo marrëveshje ndonjëherë i shkelte të drejtat e tyre fetare, pasi ata përballeshin me frikësim ose pengoheshin të zhvillonin ceremoni varrimi sipas zakoneve të tyre. Disa komuna, si Gjilani, u përpoqën t'i ndanin varrezat komunale në pjesë dhe t'ia ndanin secilën pjesë një komuniteti tjetër fetar. Në këto raste, disa grupe fetare që nuk ishin të lidhura me BIK-un, si protestantët dhe romët myslimanë, thanë që BIK-u i diskriminoi duke ua kushtëzuar varrosjen e anëtarëve të komunitetit të tyre me pagimin e tarifave vjetore të anëtarësimit, si dhe tarifën për pjesëmarrjen e një imami dhe kryerjen e riteve fetare islame. Komunitetet e krishtera katolike dhe ortodokse të Prishtinës vazhduan të përdorin varreza të veçanta publike.

KOS-i theksoi që ndonëse ligji kërkon konsultim për aktivitetet që ndodhin brenda ZVM-ve, qeveria nuk e respektoi ose zbatoi këtë kriter në Novobërdë; KOS-i tha që nuk ishte njoftuar për punët restauruese të drejtuara nga qeveria, një kremtim i sponsorizuar nga qeveria i festivalit "Ditët e Artanës (Novobërdës)" në kalanë e Novobërdës, ose një meshë katolike e mbajtur në një vend fetar të pretenduar nga KOS-i.

Me pëlqimin e qeverisë, OSBE-ja mbikëqyri zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e ZVM-ve përreth vendeve fetare dhe të trashëgimisë ortodokse serbe.

Udhëheqja e BIK-ut raportoi që një grup qytetarësh nga Mitrovica lobi për rindërtimin e një xhamie në Mitrovicë veriore, të cilën forcat e Republikës Federale të Jugosllavisë e shkatërruan në vitin 1999, por kundërshtimi nga serbët lokalë vazhdoi t'i prishte planet për rindërtim.

Planet për një xhami të madhe në Prishtinë ngecën, sepse leja për ndërtim e vitit 2018 kishte skaduar dhe zhvilluesit prisnin përtëritjen e lejes. Disa imamë vendas raportuan që nuk kishte kërkesë për një xhami kaq të madhe në qytet, ndërsa zyrtarët qeveritarë ngritën shqetësime për prishje të ndërtesave, pengim të trafikut dhe parkimit.

Në fund të vitit, komuna e Prishtinës dhe bashkësisë hebraike vazhduan të mos pajtoheshin për një lokacion të përshtatshëm për një sinagogë, për të cilën komuna kishte lëshuar leje ndërtimi në vitin 2016. Bashkësia hebraike refuzoi ngastrën e tokës në periferi të qytetit që qeveria

komunale ia ofroi, ndërsa qeveria hodhi poshtë kërkesën e kësaj bashkësie për një lokacion në afërsi të qytetit të Prishtinës.

MKRS-ja ndau 50.000 euro (56.200 dollarë amerikanë) për rindërtimin e qendrës së bashkësisë hebraike në Prizren; megjithatë, projekti mbeti pezull derisa bashkësia hebraike ta siguronte pjesën e mbetur të fondeve të nevojshme.

Zyrtarë komunalë të Deçanit vazhduan ta refuzojnë zbatimin e një vendimi të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2016, që e mbështeste aktvendimin e Gjykatës Supreme të vitit 2012, që ia njihte pronësinë për afro 24 hektarë tokë Manastirit të Deçanit të KOS-it. Kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, dhe kuvendi komunal vazhduan të deklarorin gjatë vitit se aktvendimi i gjykatës ishte “i papranueshëm”. Zyrtarët e qeverisë qendrore nuk ndërmoren asnjë veprim për ta zbatuar vendimin e gjykatës. Trupat e Forcës së Kosovës (KFOR) vazhduan të ofronin siguri në manastirin e Deçanit.

Qeveria komunale e Deçanit, me mbështetje nga autoritetet qendrore, vazhdoi përpjekjet e veta për ta ndërtuar një rrugë kryesore tranzitore afër Manastirit të Deçanit. Pas braktisjes së mëparshme të punëve në rrugën brenda ZVM-së, Ministria e Infrastrukturës dhe komuna vazhduan ndërtimin e saj nga të dy anët ngjitur me ZVM-në; manastiri tha se këtë e interpretonte si lëvizje për ta detyruar KOS-in që ta pranonte ndërtimin e rrugëve përmes ZVM-së, përkundër një ndalesë legislative për aktivitete të tilla dhe një opinion të KZM-së që rruga do ta cenonte ligjin.

Më 26 shkurt, gjykata e apelit vendosi në favor të pronësisë së Kishës Katolike për më shumë se 7.500 metra katrorë tokë ngjitur me Katedralen Nëna Terezë, duke hedhur poshtë kërkesën e komunës së Prishtinës për këtë tokë.

Sipas BIK-ut, qeveria qendrore vazhdoi të siguronte disa fonde për arsimin islam në medresenë e BIK-ut në Prishtinë dhe degët e saj në Prizren e Gjilan. KPUK-u dhe zyrtarë të universitetit publik thanë që besojnë se ky financim ishte diskriminues, sepse qeveria nuk siguroi fonde për arsimin fetar për ndonjë grup tjetër fetar.

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit vazhdoi t'i lironte nga pagesa e shërbimeve për ujë ndërtesat fetare që u takojnë pesë bashkësisë fetare “tradicionale”. Grupe të tjera fetare paguanin për tarifa të ujit.

Sipas KPUK-ut, zyrtarët doganorë hoqën dorë nga një gjobë e vendosur ndaj KPUK-ut në vitin 2017 për keqpërdorim të importeve pa taksa për organizata fetare, me arsyetimin se statusi juridik i atij hetimi nuk ishte zgjidhur plotësisht. Një opinion ligjor i OSBE-së, i vitit 2017, citoi kundërthënie në ligj lidhur me shitjen e mallrave për qëllime bamirësie.

Seksioni III. Statusi i respektit shoqëror për lirinë fetare

Policia Kombëtare raportoi për 61 incidente me motive fetare në nëntë muajt e parë të vitit, shumica e të cilave kishin në shënjestër vendet ortodokse dhe myslimane dhe përfshinin vjedhje ose dëme pronësore, si përdhosja e varrezave, krahasuar me 86 raste të një natyre të ngjashme në vitin 2018. Pasi feja dhe përkatësia etnike shpesh janë të lidhura ngushtë, nganjëherë ishte vështirë të kategorizoheshin incidentet si incidente të bazuara në identitet fetar.

Më 6 janar, sipas KOS-it, një grup i shqiptarëve të Kosovës abuzoi verbalisht priftin e KOS-it, Bojan Jevtiq, duke e quajtur atë “Çetnik” dhe e kërcënuan se do ta masakrojnë para kishës së tij në komunën e Novobërdës. Sipas Jevtiqit, pasi ai paraqiti ankesë, policia nuk i vazhdoi hetimet.

Më 6 janar, një grup i shqiptarëve të Kosovës, përfshirë familjet e personave të zhdukur, protestuan kundër vizitës së paralajmëruar vjetore me rastin e krishtlindjeve ortodokse të pelegrinëve ortodoksë serbë në kishën lokale të KOS-it në Gjakovë. Pelegrinët u njoftuan për protestat e paralajmëruara dhe e anuluan vizitën e tyre për shkak të shqetësimeve për siguri. Protesta përfundoi pasi protestuesit vendosën një listë të kriminelëve të luftës të supozuar serbë në derën e kishës, duke thënë se ishin kundër “kriminelëve të maskuar si pelegrinë”.

KOS-i tha që raportimi i mediave i kontribuoi një klime jotolerante ndëretnike e ndërftare gjatë vitit. KOS-i gjithashtu u ankua për deklaratat publike të OJQ-së “Historianët e Deçanit” kundër igumenit të Manastirit të Deçanit, Atit Sava Janjiq, dhe peshkopit të Rashkës-Prizrenit, Teodosije Sibaliq.

BIK-u tha që shpeshësia e raporteve dhe deklaratave të mediave anti-myslimane në rrjetet sociale u rrit, dhe sekularistët i përdorën mediat dhe rrjetet sociale për t’i portretizuar negativisht myslimanët. Një gazetar iu referua myslimanëve që ishin pro-Erdoganit si “banorë të shpellave”, “plehra” dhe “talebane”.

BIK raportoi për një rast të një gruaje që iu mohua kontrata e punës në sektorin privat. BIK-u tha se gratë “e përkushtuara” myslimane rrallë i raportuan rastet e diskriminimit në baza fetare.

Në korrik, vandalët shkatërruan 20 gurë varresh në një varrezë të KOS-it në komunën e Lipjanit dhe, në shtator, disa gurë varresh u shkatërruan në një varrezë të KOS-it në komunën e Ferizajt. Përfaqësuesit e KOS-it përsëri thanë që besonin se incidentet që synonin vendet e KOS-it ishin të nxitura më shumë nga përkatësia etnike sesa nga feja.

Në shtator, vandalë të panjohur thyen një pllakë në pjesën e varrezave të caktuar nga komuna e Gjilanit për komunitetin ungjillor protestant; KOS-i pretendoi pronësinë e parcelës së caktuar dhe refuzoi vendimin e komunës.

Në mars, kroatët etnikë raportuan për shkatërrimin e simboleve fetare në kishën katolike në fshatin Janjevë. Një hetim policor për këtë incident ishte duke vazhduar në fund të vitit.

Udhëheqësit e grupeve fetare vazhduan të takoheshin herë pas here për diskutime ndërftare për të drejtat pronësore, prioritetet legjislative dhe çështje të bashkësive lokale. OSBE-ja vazhdoi t’i koordinonte disa aktivitete mes grupeve fetare, përfshirë takimet me autoritetet qendrore e lokale, për t’i diskutuar çështjet si lejet për të ndërtuar objekte fetare. OSBE-ja gjithashtu përfshiu përfaqësues të të gjitha bashkësive kryesore fetare në këshillat komunale për siguri në bashkësi, të cilët u takuan për t’i diskutuar çështjet e sigurisë.

Seksioni IV. Politika dhe angazhimi i Qeverisë Amerikane

Ambasadori dhe zyrtarë të tjerë të ambasadës kërkuan nga zyrtarët e qeverisë qendrore e lokale, përfshirë kryeministrin, që ta respektonin ligjin dhe ZVM-të, posaçërisht në rastin e rrugës së planifikuar afër Manastirit të Deçanit. Zyrtarët e ambasadës biseduan me të gjitha nivelet e qeverisë për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2016 që urdhëronte kthimin

e tokës Manastirit të Deçanit, duke nxitur qeverinë dhe gjyqësorin që t'i mbanin përgjegjës zyrtarët lokalë. Ambasadori dhe zyrtarët e tjerë të ambasadës diskutuan çështjet pronësore të grupeve të tjera fetare me zyrtarë të qeverisë dhe u bënë thirrje që ta respektojnë lirinë fetare dhe pluralizmin, dhe ta rrisin komunikimin e tyre me grupet fetare. Zyrtarët e ambasadës i kërkuan zyrës doganore në shumë raste që ta shtynte lëshimin e thirrjeve për gjykatë për KPUK-un për keqpërdorim të importeve pa doganë deri në sqarimin e Kodit Doganor dhe të ligjit që mbulonte përjashtimet doganore për organizatat fetare.

Zyrtarët e ambasadës u takuan shpesh me udhëheqës fetarë për ta promovuar lirinë dhe tolerancën fetare dhe për ta përmirësuar komunikimin ndërfaqetar. Ata u takuan me imamët e BIK-ut dhe anëtarët e Fakultetit të Fesë Islame në Prishtinë për t'i diskutuar përpjekjet për ta mbështetur tolerancën dhe diskutuan ndryshimet e propozuara në Ligjin për Lirinë Fetare. Ata gjithashtu folën në xhami si folës të ftuar para namazit të së Premtes për rëndësinë e pluralizmit fetar. Personeli i ambasadës shpesh postonte porosi në mediat sociale në mbështetje të lirisë fetare, si shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Lirisë Fetare në tetor dhe promovimi i Ministerialit për Përparimin e Lirisë Fetare në korrik.

Në nëntor, Ambasadori amerikan për Liri Fetare Ndërkombëtare u takua me përfaqësuesit e të gjitha bashkësive kryesore fetare, duke i nxitur për respekt dhe mbështetje të ndërsjellë për pluralizmin fetar, si dhe duke mbrojtur krijimin e një këshilli ndërfaqetar. Në lidhje me këtë vizitë, zyrtarët e ambasadës organizuan një ngjarje rinore me udhëheqës të ri të emëruar nga bashkësitë e ndryshme fetare dhe organizatat laike.